



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRAN

Nr. / Br. 19360/21

Nr. i fq. / Br. st. 2

Data: / Datum: 07.05.2021



REPUBLICA E KOSOVËS

VUÇITRAN - VUÇITRAN KOMUNA E VUSHTRISË

Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel.028 571343

| | |
|------------------------|--|
| DATE/A: | 07.05.2021 |
| REFERENC-Ë: | 09.Nr15/2021 |
| PËR/ZA/TO: | Aplikim për "Furnizim me Pajisje për Bletë" |
| NGA/OD/FROM: | Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Z. Kujtim Pllana |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Thirrje për Aplikim |



Njoftohen të gjithë të interesuarit se mund të aplikojnë në thirrjen e Komunës së Vushtrrisë - DEBPZHR-së **Furnizim me Pajisje për Bletë**, aplikacioni merret në zyrat e DEBPZHR.

Pajisjet që do të përfitohen

- 10x Koshere 3 katshe Antivaro
- 1x Centrifugë Elektrike për katër (4) korniza - Inox
- 1x Tymosësë - Inox
- 1x Kantë mjalti 50l - Inox
- 1x Kullosje me dy sita - Inox
- 1x Kapse dhe thikë - Inox
- 1x Uniforma me dorëza

I. Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:

1. Të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë;
2. Të jetë i moshës 18-65 vjeçar;
3. Të jetë prodhues mjalti dhe të posedoj mbi 10 shoqëri bletësh;
4. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar më parë (tri vitet e fundit);
5. Përfituesit duhet të participojnë në financimin e projektit në vlerë prej 200 euro nëse përzgjidhet si përfitues:



II. Përzgjedhja e përfituesit do të bëhet duke u bazuar në kriteret e më poshtme;

| | | | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| 1 | Kategoritë e familjeve me jetim, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidë ose veteranë | 10 pikë | | | |
| 2 | Fermeri që nuk ka qenë përfitues ose ka qenë përfitues sipas viteve | Asnjëherë 30pikë | Vitin 2018 10 pikë | Vitin 2019 4 pikë | Vitin 2020 2 pikë |
| 3 | Fermeri që posedon shoqëri bletësh | 10-29 sh. 20 pikë | 30-40 sh. 10 pikë | 40-50 sh. 6 pikë | Mbi 50 4 pikë |
| 4 | Kapaciteti i aplikuesit për jetësimin e grantit (vlerësimi nga terreni) | 20 pikë | | | |
| | Numri maksimal i pikëve | 80 pikë | | | |

Vërejtje:

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve dhe tentimit për mashtrim do të aplikohen masa ndëshkimore duke mos i dhënë mundësi përfitimi për tre vitet e ardhshme.

Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohen për shqyrtim.

Dokumentet për aplikim:

1. Aplikacioni i plotësuar;
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Vërtetimin për kryerjen e obligimeve komunale (tatimi në pronë, mbeturinat);
4. Certifikatën e bashkësisë familjare - jo më e vjetër se 6 muaj(edhe kopje);
5. Dëshminë për kategoritë e familjeve me jetim, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidë ose veteranë.

***Aplikohet në zyrën pritëse të Komunës
Afati i fundit për aplikim: 22/05/2021 ora 15:30.***

